

Qershor 2024



Parimet kryesore për një rrjet elektrik miqësor ndaj shpendëve në Evropë

Përgatitur nga komuniteti evropian i ruajtësve të natyrës



Hyrje

Për të arritur emetimet neto zero deri në vitin 2050, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit¹, shoqëritë tona duhet të kalojnë në një sistem energjie të bazuar në burimet e rinovueshme. Për të integruar pjesën në rritje të burimeve të rinovueshme të energjisë (RES) dhe për të përmbushur objektivin detyrues prej të paktën 42.5% RES të konsumit bruto të energjisë finale deri në vitin 2030², infrastruktura e rrjetit të energjisë elektrike në të dy nivelet e transmetimit dhe shpërndarjes në të gjithë Evropën duhet të përforcohet dhe të zgjerohet me hapa më të shpejtë.

Suksesi i tranzicionit të energjisë është i lidhur ngushtë me të kuptuarit në mënyrë proaktive dhe zbutjen e ndikimeve në mjedis që lidhen me infrastrukturën e rrjetit të energjisë. Masat e duhura të ndërmarra për natyrën, të lidhura me vendosjen e rrjetit, do të sigurojnë që ne të adresojmë në mënyrë të ndërthurur sfidën e trefishtë të krizës klimatike, energjisë dhe biodiversitetit. Rrjetet e mirë-projektuara të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike luajnë një rol kyç në mbrojtjen e shpendëve dhe habitateve me rëndësi (p.sh. habitatet e Natura 2000) duke parandaluar humbjen e tyre dhe duke siguruar qëndrueshmërinë e popullatave specifike. Kur shpendët dhe habitatet e tyre nuk merren parasysh në proceset e projektimit dhe mirëmbajtjes, rreziqet që paraqesin rrjetet për ata, rriten. Rreziqe të tilla përfshijnë përplasjet me linjat e energjisë, që ndodhin në rrjetet e shpërndarjes ose transmetimit të energjisë elektrike, goditjet elektrike, të lidhura kryesisht me rrjetet e tensionit të mesëm dhe shqetësimet nga aktivitetet njerëzore gjatë operacioneve të mirëmbajtjes dhe monitorimit, që ndikojnë në mbijetesën e llojeve të caktuara. Masat kryesore për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve për llojet e shpendëve përgjatë linjave të energjisë përfshijnë shmangien e ndërtimit në zona të ndjeshme, instalimin e devijuesve të fluturimit të shpendëve për të reduktuar përplasjen, përdorimin e modeleve të shtyllave miqësore me shpendët për të reduktuar goditjet elektrike dhe kur është e mundur, instalimin e linjave nën tokë për të eliminuar plotësisht rrezikun për shpendët.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme të rrjetit elektrik përkrah me ekspertët e ruajtjes së natyrës, në përputhje me qëllimet e Strategjisë së BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030, legjislacionin përkatës të natyrës (d.m.th., Direktivat e Shpendëve dhe Habitave), si dhe Ligjin e ardhshëm të BE-së për Restaurimin e Natyrës.

Në këtë kontekst, në nëntor 2023 projekti LIFE 'SafeLines4Birds³' mbajti një seminar me temë 'Ndërlidhja e biodiversitetit'. Përfaqësues nga 20 organizata mjedisore në 12 vende të Evropës u mblodhën në një takim dy-ditor për të diskutuar gjendjen aktuale të mbrojtjes së shpendëve që preken nga rrjeti elektrik, zgjidhjet dhe strategjitë e mundshme të zbutjes së efekteve të rrjetit tek shpendët, si dhe identifikimin e prioriteteve dhe hapave të ardhshëm drejt një infrastrukture miqësore me shpendët.

1 <https://www.pac-scenarios.eu/>

2 Directive (EU) 2023/2413 of the European Parliament and of the Council of 18 October 2023 as regards the promotion of energy from renewable sources

3 SafeLines4Birds is a 6-year project which aims to reduce non-natural mortality of 13 bird species by reducing the negative impact of their interactions with power lines in France, Belgium and Portugal.



Renewables Grid Initiative (RGI) kishte rolin organizues dhe moderues në takim. Opinionet e shprehura gjatë seminarit në këtë dokument përfshijnë organizatatat pjesëmarrëse dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të rrjetit RGI.

Ky dokument përmbledh të gjitha diskutimet e seminarit dhe ofron një përmbledhje të parimeve kryesore që duhet të merren parasysh për një rrjet elektrik miqësor ndaj shpendëve në të gjithë Evropën. Gjatë seminarit u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet rrjetit dhe organizatave të ruajtjes së natyrës në mënyrë që parimet e paraqitura më poshtë të zbatohen në mënyrë sa më efektive. Prandaj, ato do të diskutohen në një seminar pasues në vitin 2024, që do të përfshijë operatorët e rrjetit të energjisë elektrike dhe palë të tjera kyçe të interesit.

Nënshkruesit e shoqërisë civile evropiane paraqesin 7 parimet e mëposhtme që mund të shërbejnë si udhëzime për tu marrë parasysh nga vendimmarrësit dhe për tu diskutuar më tej me aktorët përkatës:

- 1** Dialogu ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në Evropë
- 2** Bashkëpunimet ndërmjet shteteve anëtare
- 3** Burime të qëndrueshme financiare për shoqërinë civile
- 4** Standardizimi i mbledhjes së të dhënave për shpendët duke përdorur një qasje me burim të hapur
- 5** Hartat gjithëpërfshirëse që paraqesin rrezik për shpendët në shkallë kombëtare
- 6** Përmirësimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator evropian
- 7** Udhëzime teknike nga Evropa

Bashkëpunimi dhe angazhimi

1

Dialogu ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në Evropë

Dialogu i hapur dhe shkëmbimi i njohurive janë thelbësore për të siguruar zbatimin e suksesshëm të masave zbutëse në mjedis. Ndërkohë që përpjekjet vazhdojnë për forcimin e bashkëpunimit midis palëve të interesit, është e nevojshme një qasje më gjithëpërfshirëse për të trajtuar në mënyrë efektive kompleksitetin e ndërveprimeve shpend-rrjet. Kjo duhet të bazohet mbi studimet dhe kërkimet mbi ruajtjen e shpendëve, risitë teknike dhe përvoja praktike.

Ne propozojmë zhvillimin e një konference dyvjeçare në mbarë Evropën për të ofruar një platformë diskutimi për palët e interesit, duke përfshirë operatorët e sistemit të transmetimit (OST), operatorët e sistemit të shpërndarjes (OSSH) dhe organizatat e ruajtjes së natyrës, për të nxitur bashkëpunimet ekzistuese dhe për të krijuar të reja. Objektivat e konferencës përfshijnë prezantime mbi studimet e realizuara dhe progresin, shkëmbimin e ekspertizës për çështje kritike dhe identifikimin e fushave që kërkojnë kërkime të mëtejshme.

Për më tepër, ne rekomandojmë centralizimin e të gjitha studimeve ekzistuese në mbarë botën në një platformë të vetme online. Kjo bazë të dhënash gjithëpërfshirëse do t'u japë palëve të interesit akses në gjetjet më të fundit dhe do të mbështesë replikimin e praktikave të suksesshme. Platforma duhet të zhvillohet në bashkëpunim me palët e interesit për të përfutur të gjithë, si politikëbërësit, shkencëtarët, industritë private dhe publiku i gjerë.

2

Bashkëpunimet ndërmjet shteteve anëtare

Palët e interesit nga secili shtet anëtar, duke përfshirë OST, OSSH, OJF dhe autoritetet publike, duhet të krijojnë ose përmirësojnë bashkëpunimet¹ ekzistuese kombëtare. Së bashku, ata duhet të zhvillojnë plane kombëtare veprimi që synojnë promovimin e rrjeteve elektrike miqësore me shpendët, duke përshkruar aksionet prioritare dhe caktuar afate të qarta kohore. Këto diskutime duhet të lehtësohen nga grupet kombëtare të punës që fokusohen në tematika për kontekstin e secilit shtet anëtar.

¹ [Comité national avifaune in France](#)
[Bird Portal working group in Germany](#)

Kjo qasje duhet të mundësojë shkëmbimin e njohurive përmes sesioneve të përbashkëta të trajnimit mbi aspektet ornitologjike dhe teknike të infrastrukturës së rrjetit të energjisë elektrike, të udhëhequra nga OJF-të dhe operatorët e rrjetit përkatësisht. Këto sesione trajnimi do të shërbejnë për ngritjen e kapaciteteve brenda organizatave përkatëse. Të dyja palët duhet gjithashtu të angazhohen për të ndarë këtë njohuri brenda strukturave të tyre për të siguruar një kuptim të gjerë të çështjes.

3

Burime të qëndrueshme financiare për shoqërinë civile

Pjesëmarrja e shoqërisë civile jo vetëm që luan një rol vendimtar në ruajtjen e shpendëve, por gjithashtu ofron informacion thelbësor për zhvilluesit e projekteve. Shoqëria civile do të vazhdojë me pozicionin e saj strategjik për të kontribuar në një zhvillim sa më të shpejtë të rrjeteve të përshtatme të energjisë elektrike, duke nxitur mirëkuptim midis palëve të interesit dhe publikut të gjerë.

Megjithatë, kapacitetet si cilësore dhe sasiore, janë një kusht për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e punës. Ne u bëjmë thirrje politikëbërësve të BE-së dhe shteteve anëtare që të sigurojnë burime të qëndrueshme financiare dhe mundësi për rritjen e kapaciteteve për organizatat e ruajtjes së natyrës, duke mundësuar angazhimin në proceset e konsultimit në lidhje me projektet e rrjetit elektrik. Këtu përfshihen nisma komunikimi që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për humbjen e popullatave të shpendëve, zgjidhjet e duhura dhe kontribuojnë në shkëmbimin e njohurive rreth rrjeteve të energjisë elektrike dhe rolit që kanë në tranzicionin e energjisë.

Financimi nuk duhet të kufizohet vetëm në fondet evropiane për ruajtjen e natyrës dhe kërkimin shkencor (p.sh. LIFE dhe Horizon Europe), por duhet të konsiderohet si një financim bazë i nevojshëm për mbrojtjen e shpendëve, si pjesë e ndërtimit dhe funksionimit të sigurt të infrastrukturës së rrjetit elektrik. Për më tepër, burime dhe mundësi financimi shtesë duhet të eksplorohen dhe përdoren, si grantet e qeverisë kombëtare, fondet e ndikimit në mjedis dhe fondet e dedikuara për ruajtjen e natyrës në nivel rajonal ose lokal.

Të dhënat

4

Standardizimi i mbledhjes së të dhënave për shpendët duke përdorur një qasje me burim të hapur

Të dhënat e standardizuara për rastet e shpendëve të vrarë si pasojë e rrjetit elektrik, të dhënat teknike të rrjetit dhe zbatimi i veprimeve zbutëse janë thelbësore për të kuptuar rreziqet e infrastrukturës ekzistuese dhe propozuar strategjitë e ardhshme të mitigimit. Për më tepër, qasja me të dhëna të përditësuara dhe me cilësi të lartë për praninë e shpendëve dhe rrugët e shtegtit, është thelbësore për vlerësimin e saktë të rreziqeve të mundshme të infrastrukturës së re dhe informimin e vendimmarrësve të planifikimit.

Aktualisht, të dhëna të tilla janë të paplota ose mungojnë në të gjithë vendet evropiane, duke e bërë të vështirë adresimin e plotë të ndikimit të infrastrukturës së rrjetit të energjisë elektrike tek popullatat e shpendëve. Për të përmirësuar këtë gjendje, ne rekomandojmë krijimin e një baze të dhënash digjitale të standardizuar dhe të centralizuar për menaxhimin e të dhënave historike dhe të ardhshme mbi rastet e humbjes së shpendëve si pasojë e infrastrukturës së rrjetit, të dhënat teknike të rrjetit dhe praninë e shpendëve, në përputhje me konventat e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë. Kjo do të lehtësonte krahasimet midis të dhënave pavarësisht nga origjina, dhe aksesin për aktorë të ndryshëm, duke mundësuar kështu vlerësime të plota shkencore dhe vendimmarrje të informuar në lidhje me ruajtjen e shpendëve rreth infrastrukturës ekzistuese dhe planifikimit hapësinor në të ardhmen. Ky mjet online duhet të jetë universalisht i përdorshëm nga operatorët e rrjetit të energjisë elektrike, organizatat e ruajtjes së natyrës e shpendëve, autoritetet kompetente dhe publiku i gjerë. Ai duhet të përfshijë seksione të përshtatura për të akomoduar preferencat e ndryshme të përdoruesit, kërkesat dhe kufizimet e aksesit (p.sh., detajet teknike të rrjetit do të jenë të aksesueshme vetëm për palë të caktuara të interesit). Gjithashtu databaza duhet të përdorë platformat¹ ekzistuese dhe miqësore për përdoruesit, dhe në këtë mënyrë të krijojë një platformë të përshtatshme në mbarë Evropën për të integruar grumbullimin e të dhënave për vdekshmërinë e shpendëve, së bashku me të dhënat për praninë e shpendëve dhe informacionin teknik të rrjetit.

1 Good examples include: Waarnemingen.be and Observations.be in Belgium, [NABU-RGI Bird-Portal](http://NABU-RGI.Bird-Portal.de) in Germany, 'Avifaune et Câbles' in France and internationally [iNaturalist](http://iNaturalist.org). Data repositories such as the [Global Biodiversity Information Facility](http://GlobalBiodiversityInformationFacility.org) (GBIF) might play an important role.

5

Hartat gjithëpërfshirëse që paraqesin rrezik për shpendët në shkallë kombëtare

Pavarësisht se disa vende të Evropës¹ kanë bashkëpunuar me kompanitë e rrjetit të energjisë elektrike për të krijuar hartën e ndjeshmërisë për popullatat e shpendëve në lidhje me infrastrukturën, sërish ka mangësi në hartën gjithëpërfshirëse në të gjithë rajonin evropian. Mjetet efektive të planifikimit hapësinor, së bashku me të dhënat e sakta, mund të përshpejtojnë zgjerimin e rrjetit elektrik duke e drejtuar vendosjen e infrastrukturës së re larg zonave me rrezik të lartë për shpendët, si dhe duke marrë parasysh shpërndarjen e tyre dhe habitatet me rëndësi.

Krijimi i hartave të rrezikut të të gjithë rajonit të Evropës do të mundësonte një planifikim më të mirë të integruar të infrastrukturës së re. Në të njëjtën kohë, do të siguronte miratimin e masave zbutëse të përshtatshme dhe efektive në rrjetin operativ të vendosur brenda zonave me rrezik më të lartë për shpendët. Për të adresuar përpjekjet e vazhdueshme të monitorimit të shpendëve dhe shpërndarjen e tyre, këto harta duhet të përditësohen rregullisht me të dhëna të reja hapësinore të rrjetit, si dhe të dhëna për praninë e shpendëve.

1 [Sensitivity mapping informs mitigation of bird mortality by collision with high-voltage power lines](#) (Paquet et al., 2022)
[Documenting and reducing avian electrocutions in Hungary: A conservation contribution from citizen scientists](#) (Demeter et al., 2018)

Rregullore dhe udhëzime

6

Përmirësimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator evropian

Strategjia e BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030, së bashku me Direktivën e Shpendëve dhe Habitave, ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse politike që lejon të gjitha shtetet anëtare të BE-së të bashkëpunojnë për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara dhe habitateve të tyre. Megjithatë, zbatimi i tij mbetet i cunguar në shtetet anëtare të BE-së. Kuadri ekzistues evropian duhet të standardizojë mekanizmat e zbatimit për të siguruar implementimin e masave për reduktimin e rrezikut të rrjeteve ekzistuese të energjisë. Kjo përpjekje duhet të bazohet në kuadrin aktual ligjor të vendeve të ndryshme të Evropës¹ dhe të përdorë dispozitat e ligjit të ardhshëm të BE-së për Restaurimin e Natyrës.

Për më tepër, nismat e ndërmarra për ruajtjen e llojeve të caktuara të shpendëve, duhet të theksohen për të sqaruar se cilat masa janë efektive për mbrojtjen e tyre gjatë planifikimit, vendosjes dhe funksionimit të rrjetit. Në këtë mënyrë, për të siguruar që monitorimet në të ardhmen të ofrojnë të dhëna të sakta dhe të krahasueshme për ndërveprimet rrjet-shpend, ne theksojmë nevojën që politikëbërësit e BE-së dhe ato në nivel kombëtar të ofrojnë udhëzime të qarta për të gjitha palët mbi - dhe kur është e nevojshme të rishikojnë - qëllimin e monitorimit, metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, si dhe aksesueshmërinë dhe transparencën e të dhënave.

Përsa i përket zbatimit të strategjive të mitigimit, kostot e teknologjive të mitigimit duhet të njihen nga autoritetet kombëtare dhe të përfshihen në shpenzimet kapitale të projekteve të reja të rrjetit. Për më tepër, analiza kosto-përfitim duhet të marrë në konsideratë rreziqe të tilla, si kërcënimet për sigurinë e furnizimit dhe rrezikun e zjarreve për shkak të goditjes elektrike të shpendëve, për të pasqyruar më saktë përfitimet e vërteta të masave parandaluese. Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të strategjive të mitigimit, kriteret e vlerësimit gjithëpërfshirës duhet të përfshihen në kuadrin e raportimit dhe monitorimit.

1 National legislation, such as the [Spanish Royal Decree 1432/2008](#) was implemented to comply with the requirements and objectives set forth in the [European Directive 2004/35/CE](#) to establish a framework of environmental liability to prevent and remedy environmental damage.

7

Udhëzime teknike nga Evropa

Aktualisht, ka mungesë të ndërgjegjësimit për zgjidhjet teknike më efektive që synojnë shmangien dhe zbutjen e rreziqeve për shpendët përgjatë linjave të energjisë, e cila nga ana tjetër parandalon aplikimin e tyre uniform dhe të qëndrueshëm. Prandaj udhëzime të unifikuara dhe koherente nga vendet e Evropës duhet të zhvillohen dhe shpërndahen, duke përshkruar praktikat më të mira në nivel evropian për:

- Modelet ekzistuese të shtyllave miqësore për shpendët dhe karakteristikat e tyre për të parandaluar goditjet elektrike të shpendëve.
- Efektivitetin e materialeve dhe teknologjisë së disponueshme izoluese
- Efektivitetin e devijuesve ekzistues të fluturimit të shpendëve për të reduktuar përplasjen e shpendëve / llojeve të prekura.
- Zhvillimin e metodave për të shmangur shqetësimin e shpendëve folezues gjatë mirëmbajtjes dhe ndërtimit të rrjetit.
- Praktikrat alternative teknike si marrja në konsideratë e kabllave nëntokësore dhe kostot përkatëse.

Nënshkruesit





Kontakt

Manon Quetstroey

Manager – Energy and Nature
Renewables Grid Initiative

manon@renewables-grid.eu
+49 30 2332 11034

Manfred-von-Richthofen-Strasse 4
12101 Berlin, Gjermani